



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME-
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIM

Data/Datum/Date:	14.12.2022
Nr./Br./No:	02/ 838
Për/Za/To:	Kuvendi Komunal - Shtime
Nga/Od/From:	Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Drejtor, Grejtalb Emini
Përmes/Preko/Through:	Kryetarit të Komunës, z. Qemajl Aliu
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim për dhënie të pëlqimit për nivelizimin dhe funksionalizimin e pjesëve të rrugëve publike me nr. të ngastrës P-01134-0 dhe P-01141-0 në Zonën Kadastrale e Carralevë

Në bazë të neni 58, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 dhe Statutit të Komunës së Shtimës, neni 53, të kërkesës së Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Propozoj dhënien e pëlqimit “Kastrioti” O.P për nivelizimin dhe funksionalizimin e rrugëve publike me nr. P-01134-0 dhe P-01141-0 në Zonën Kadastrale e Carralevë të evidentuara në emër të Komunës së Shtimës me qëllim të marrjes së Licencës për Shfrytëzim nga KPMM.

Arsyetim

Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi me kërkesën e “Kastrioti” O.P. me nr të biznesit 810620915 me seli në Carralevë, Komuna Shtime, është kompani e cila operon në eksploatimin e masës gurore në ZK Carralevë sipas kontratave valide të nënshkruara me Autoritetin e Pyjeve të Kosovës. Me qëllim të funksionalizimit të eksploatimit të masës gurore dhe Licencimi për Shfrytëzimin nga ana KPMM-së, ka kërkuar dhënien e pëlqimit për nivelizimin dhe funksionalizimin e pjesëve të rrugëve publike të lartëshënuara. Drejtoria pas daljes në terren ka konstatuar se përkundër mnyrës së rregullt të eksploatimit të masës gurore nga ana e “Kastrioti” O.P. sipas dokumentacionit të rregullt të lëshuar nga ana e organeve kompetente komunale, pasiqë operon në dy anët e pjesëve të rrugëve publike, pjesët e rrugëve me nr të ngastres P-01141-0 dhe P-01134-0 janë bërë të pa kalueshme dhe nuk mundë të shrytëzohen në kufijt kadastrale ekzistues nga personat të cilat i frekuentojn pronat e tyre në këto anë,

Dhënja e pëlqimit “Kastrioti” O.P konsiston për nivelizimin dhe funksionalizimin e rrugëve publike me nr P-01134-0 dhe P-01141-0 në Zonën Kadastrale e Carralevë, njëherit edhe marrje të Licencës për Shfrytëzim nga KPMM.

Kompania “Kastrioti” O.P. me seli në Carralevë, merr përsipër nivelizimin e pjesëve të rrugëve të sipër shënuara, funksionalizimin dhe mirmbajtjen e këtyre pjesëve të rrugëve publike duke ofruar qasje për të gjithë subjektet pa dallim.

Bashkangjitur janë Certifikata e pronës kopja e planit dhe skicat me ortofoto për pjesët e ngastrave e cila është objekt propozimi për dhënie Pëlqimi.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY



EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : PASURI SHOQËRORE RRUGË TË PAKATEGORIZUARA


Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	2002/22
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	15.12.2022 - 08:36
Komuna / Opština / Municipality:	SHTIME / ŠTITMLJE / SHTIME
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastrol Office:	SHTIME / ŠTITMLJE / SHTIME

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afatizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Lichen broj/broj poslovanja ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Drzava državljanstva ili uknjiženja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivania Date of Birth/Establishmen t	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
PASURI SHOQËRORE RRUGË TË PAKATEGORIZUARA			/	KCID2803818	KOSOVA/ KOSOVO/ KOSOVO			

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Azurirano Updated
CARRALEVË / CRNOLEVO / CARRALEVË		000	CARRALEVË	



B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Njesia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale Katastarska Zona Cadastral zone	Lloji i njësish Vista jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vista imovine Property kind	Kat/ Kati Br: Sprat a/ Spratova Floor number	Vendi i kualit Zvano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shfrytëzimi aktual/Kultura- klasa Aktuelna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vista prava Type of the right	Azhuruar Azurirano Updated
P-72809089-01134-0	SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME	Carraleve / Crnojevo / Carraleve	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shogëitore Drushveina Imovina Socially owned Land /		SHUSHU BRAD / SHUSHU BRAD / SHUSHU BRAD	1694	Infrastruktura - Rrugë E Pakategor - / / Infrastruktura - Nekategorisani Put - / / Infrastruktura - UncategorizedRoa d - / /	1 / 1	Posehim individual / Individualna Dravina / Single possessor	
P-72809089-01141-0	SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME	Carraleve / Crnojevo / Carraleve	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shogëitore Drushveina Imovina Socially owned Land /		SHUSHU BRAD / SHUSHU BRAD / SHUSHU BRAD	979	Infrastruktura - Rrugë E Pakategor - / / Infrastruktura - Nekategorisani Put - / / Infrastruktura - UncategorizedRoa d - / /	1 / 1	Posehim individual / Individualna Dravina / Single possessor	



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : SHTIME

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Carralevë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-72809089-01134-0	Parcelë / Parcela / Parcel	1694
P-72809089-01141-0	Parcelë / Parcela / Parcel	979



Shkalla/Razmera/Scale: 1:3113

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 15.12.2022

Koha/ Vreme/ Time: 08:39:27

Nënshkrimi/Potpis/Signature:


Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director


Nënshkrimi/Potpis/Signature:



CARRALEVĚ



CARRALEVĚ





KASTRIOTI

N.U.I: 810620915

Tel: 049 864 111

Carralevë - Shtime

Për: Kuvendi Komunal – Shtime

Drejtuar: Kuvendi-t Komunal - Shtime

Nga: Kompania "Kastrioti" O.P – Carralevë – Shtime

Lënda: Kërkesë për vendosjen në rend të ditës me urgjencë për shqyrtimin e kërkeses Nr.01-070/05-17731, drejtuar Kuvendit Komunal Shtime nga kompania Kastrioti O.P me datë: 06.07.2022

Të nderuar/a,

Kompania Kastrioti O.P, me datë: 06.07.2022 i ka drejtuar Kuvendi-t Komunal Shtime Kërkesë për lëshimin e **Pëlqimit** për përdorimin e rrugëve ekzistuese përkatësisht parcelat në zonën kadastrale Carralevë – Shtime me nr. 01141-0 dhe 01134-0, dhe prej dorëzimit të kërkeses, kërkesa nuk është shqyrtuar ende nga Kuvendi Komunal Shtime.

Kompania Kastrioti O.P posedon Licencë Shfrytëzimi për guri gëlqeror nr.2270/KPMM/2022 e vlefshme deri me datë: 03.06.2023, për parcelen nr.01133-0, pasi kjo licencë është afër skadimit dhe rezervat e shfrytëzueshme të gurit gëlqeror janë afër shterimit kompania jonë ka aplikuar në Komisionin e pavarur për miniera dhe minerale (KPMM) për Licencë Shfrytëzimi të gurit gëlqeror për parcelat 01140-0, 01142-0 dhe 01133-0 në mënyrë që të vazhdojë ushtrimin e veprimtarisë së kompanisë dhe pas shqyrtimit të aplikimit ne kemi pranuar një Vërejtje nga KPMM me datë 26.09.2022, ku citohet se: “zona e licences është e ndarë në dy pjesë” gjë që nënkupton se parcelat i ndan rruga dhe për këtë arsye na u nevojitet pëlqimi nga ana e Kuvendit Komunal Shtime, Vërejtja e lëshuar nga KPMM ka afat për përmbushjen e këtij kushti 30 ditë në të kundërtën, refuzohet aplikacioni i Licences së Shfrytëzimit. Me datë 25.10.2022 ne kemi bërë kërkesë në KPMM që të na mundësojnë shtyerjen e afatit dhe për 60 ditë tjera.

Pa marrjen e pëlqimit nga ana e Komunes së Shtimes, ne nuk mund të pajisemi me Licencë Shfrytëzimi nga ana e KPMM-së, e mos pajisja me Licencë Shfrytëzimi nënkupton ndërprerjen e ushtrimit të veprimtarisë sonë, gjë që do të na shkaktonte dëme të pariparueshme, pasi momentalisht në kompaninë tonë janë të punësuar 40 puntorë, dhe ndërpreja e veprimtarisë do të shkaktonte humbjen e 40 vendeve të punës, poashtu kompania jonë është e inkuadruar në projekt ndërkombëtar për rehabilitimin e


hekurudhave të Kosovës, dhe mos mundësia e furnizimit me zhavor për këtë projekt do të na shkaktonte dëme shumë të mëdha.
Andaj kërkojmë nga Kuvendi Komunal Shtime që kërkesen tonë me nr.01-070/05-17731 ta trajtojë me prioritet dhe në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit ta vendos në rend dite dhe të bëhet shqyrtimi i kërkeses.


Mbesim me atë se kërkesa jonë do të gjej mirëkuptim dhe përkrahje nga ana juaj.
Ju falënderojmë për mirëkuptim dhe bashkëpunim.

Më: 18.11.2022
Carralevë

vv

“Kastrioti” O.P
Kastriot Fazlija 049 864 111





Date / Datum / Date:



Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Prishtinë, 26.09.2022

KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE - Në bazë të nenit 22 paragrafi 1.5 të ligjit Nr. 03/L-163 Për Minerat dhe Minerale; në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 07/2007 mbi Rregullat dhe Procedurat për Pranimin dhe Përpunimin e Kërkesave për Licenca dhe Leje, pas shqyrtimit të kërkesës Nr. 3087 për Licence të hulumtimit të ndërmarrjes; "Krašnik C.P." Pronar; Krašnik Bazar, Adresa; Prishtinë, Kosovë, KPMMi-ja lëshon këtë:

VËREJTJE

1. Zona e licences është e ndarë në dy pjesë.
2. Mungon Pëlqimi nga APK për parcelat ku kërkohet leje.
3. Ndërmarrja duhet të sjell marrëveshje me pronaret e objekteve të cilat ndodhen brenda zonës 500 m, KPMMi do të pranoj marrëveshjet e noterizuara me pronaret e evidentuar në kopjen të plani dhe listat posedues jo më të vjetra se 6 muaj.


Aplikacioni i ndërmarrjes tuaj do të shqyrtohet pas përmbushjes së kushteve të parashtruara nga KPMMi, përndryshe aplikacioni për Licence të hulumtimit i Ndërmarrjes tuaj do të refuzohet si i pakompletuar në bazë të autorizimeve të dhëna me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Afati për evitim e këtyre vërejtjeve është 30 ditë nga dita e pranimit të kësaj shkrese në të kundërtën aplikacioni juaj do të refuzohet.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

Ramiz Krašniqi
Drejtore

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale



3087

26.09.2022

Rr. Armend Daci Nr.1
Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (38) 240 252
Fax: +383 (38) 245 844
E-mail: icm@kosovaminimga.org
Web: www.kosovaminimga.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo



KASTRIOTI

N.U.I: 810620915

Tel: 049 864 111

Carralevë - Shtime

Për: Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

Drejtuar: Drejtorit të KPMM

Nga: Kompania "Kastrioti" O.P. – Carralevë – Shtime

8680

25/10/2022

Pas pranimit të VËREJTJE-s me numer të protokollit: 3297 të datës 26.09.2022 pranuar më datë 27.09.2022 parashtrojmë këtë:

K Ë R K E S Ë

Kompania Kastrioti O.P ka pranuar vërejtjen tuaj për përmbushjen e kushteve nga ana jonë për aplikacionin nr.3087 për Licencë të shfrytëzimit dhe përkatësisht nga ana juaj është kërkuar që brenda afatit prej 30 ditëve nga data e pranimit të vërejtjes të plotësohen kushtet siç vijon:

1. Zona e Licences është e ndarë në dy pjesë.
2. Mungon pëlqimi nga APK për parcelat ku kërkohet leje
3. Ndërmarrja duhet të sjellë marrëveshje me pronaret e objekteve të cilat ndodhen brenda zonës 500 m, KPMM do ti pranoj marrëveshjet e noterizuara me pronaret e evidentuar në kopjen të plani dhe listat posedues jo më të vjetra se 6 muaj.

Nga kushtet e lartcekura ju njoftojmë se deri me datë 25.10.2022, kemi arritur ta plotësojmë kushtin nr.3 në tërësi ku dhe i kemi dorëzuar në KPMM memorandumet e mirëkuptimit të noterizuara me pronaret e objekteve së bashku me Certifikatat e pronësisë dhe kopjet e planeve, ndërsa për kushtet nr.1 dhe nr.2 duam të ju njoftojmë se kompania jonë ka aplikuar në institucionet kompetente për lëshimin e pëlqimeve por që deri me këtë datë nuk kemi pranuar ende përgjigje zyrtare nga ana e institucioneve kompetente përkatësisht nga Kuvendi Komunal Shtime dhe Agjencia Pyjore e Kosovës. Andaj, kërkojmë nga ana juaj që të na jepni afat shtesë prej 60 ditëve në mënyrë që të i plotësojmë edhe kushtet nr.1 dhe nr.2, pasi që plotësimi i këtyre dy kushteve nuk nvarret nga ana jonë por nga ana e institucioneve kompetente.

Bashkangjitur me këtë shkresë gjenden:

1. Kërkesa drejtuar Kuvendi Komunal Shtime me datë 06.07.2022 dhe
2. Aplikacioni për dhënien e pëlqimit drejtuar Agjencia Pyjore e Kosovës e protokoluar me datë 06.06.2022.

Ju falënderojmë për mirëkuptim dhe bashkëpunim.

Më: 25.10.2022
Carralevë

vv

"Kastrioti" O.P
Kastriot Fazlija